

V E N D I M
Nr.330, datë 29.5.2003

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.439, DATË 4.8.2000 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË
HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9 pika 2 paragrafi i dytë e 83 paragrafi i tretë të ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 “Për të huajt”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Ministrit të Rendit Publik dhe Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në lidhjen nr.8 “Praktika e lëshimit të vizës në Republikën e Shqipërisë” të bëhen shtesa dhe ndryshime, si më poshtë vijnë:

a) Në listën “Vendet, shtetasit e të cilave hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa vizë, duke paguar taksën e hyrjes (kur udhëtojnë me pasaporta të thjeshta), të shtohen shtetet:

- “- Bullgaria- Kroacia - Estonia
- Çekia - Polonia- Letonia
- Hungaria- Rumania- Lituania
- Sllovenia - Sllovakia.”.

b) Në listën “Vendet, shtetasit e të cilave hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa vizë dhe pa pagesë, (kur udhëtojnë me pasaportë diplomatike ose shërbimi)” aty ku thuhet Italia dhe Rumania, të hiqet shënimi “vetëm diplomatike.”.

2. Në lidhjen 8/1, “Praktika e lëshimit të vizës në Republikën e Shqipërisë”, pikat 1 e 2 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Shtetasit e huaj me kombësi shqiptare hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë periudhës së sezonit turistik veror, 1 qershor deri më 30 shtator, pa vizë, duke i paraqitur policisë kufitare çdo dokument të vlefshëm udhëtimi.

2. Në territorin e Republikës së Shqipërisë, gjatë periudhës së sezonit turistik veror, 1 qershor deri 30 shtator, hyjnë pa vizë shtetasit e shteteve të mëposhtme:

- Serbi–Mali i Zi
- Bosnjë-Hercegovinë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano